

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", merr pjesë për të dytin vit radhazi në Konferencën Vjetore Shkencore Ndërkombëtare të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, Kosovë.

Në konferencën me temë "Identiteti Shkencor dhe Kreativiteti në një Botë të Ndryshuar", u ofrua pjesëmarrja me prezantime të rezultateve të kërkimit në një nga 5 seksionet e konferencës:

- 1) Sfidat aktuale në dixhitalizim
- 2) Kërkimet aktuale në matematikë
- 3) Sfidat aktuale në arsimin shkollor
- 4) Mundësitë dhe sfidat për Zhvillimin Ekonomik
- 5) Drejtësia pozitive dhe shteti ligjor

Konferenca është kthyer në një vend takimi dhe platformë për studiues, mësues edukatorë dhe politikëbërës nga rajoni dhe e gjithë bota.

